




NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#98

REGJISTRI SHTETËTOR/ Certifikohen mësuesit e parë për mësimin e gjuhës shqipe në Diasporë



Mësuesit e gjuhës shqipe në Diasporë tashmë nuk do të njihen vetëm si mësuesit vullnetarë të gjuhës shqipe të komuniteteve shqiptare pjesë e të cilëve janë, por ata do të jenë pjesë e një regjistri shtetëtor i cili garanton cilësinë e mësimdhënies në Diasporë. Nisur si propozim i Ministrit të Shtetit për Diasporën, Z. Pandeli Majko dhe miratuar rreth dy vite më parë (shkurt 2019) nga Këshilli i Ministrave ky regjistër ditën e djeshme është plotësuar me 26 mësues, të cilët kanë aplikuar dhe përbushur kriteret.

Mësuesit shqiptarë prej vitesh japi kontributin e tyre në mësimdhënien e gjuhës shqipe në vendin ku jetojnë. Një mision ky, që përvece profesionistë i shndërron ata në misionarë të ruajtjes dhe trashëgimit të gjuhës, traditave dhe kulturës shqiptare.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimin e dokumentave të tyre biometrike , si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

Bashkëpunimi i Diasporës/ AKD firmos marrëveshjen me Urdhrin e Stomatologut

Nxitja e bashkëpunimit të Diasporës shqiptare dhe promovimi i vlerave të saj në fushën e stomatologjisë është qëllimi i memorandumit të firmosur midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Urdhrit të Stomatologut në Shqipëri.

Nëpërmjet këtij memorandumit këto dy institucione të përfaqësuar nga Presidenti i Urdhrit të Stomatologut, Nikoll Deda dhe Drejtoreshës Ekzekutive të AKD-së Sonila Hysi, do të bashkëpunojnë për realizimin e rrjetëzimit të profesionistëve shqiptarë në fushën e stomatologjisë në Diasporë, me qëllim krijimin, koordinimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave mbi stomatologët dhe ndihmëstomatologë shqiptarë, që ushtrojnë profesionin e tyre brenda dhe jashtë vendit.



Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

VOTA E DIASPORËS/ Viojnë konsultimet me KKD dhe institucioneve zgjedhore



Këshilli Koordinues i Diasporës vijon serinë e takimeve për votën e Diasporës, mbi aktet që pritet të miratohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në mbledhjen e fundit ishte përfaqësuesi i Partisë Demokratike i cili tha se do të paraqesë shumë shpejt propozimet që më pas Rregullatori të vijojë me miratimin e akteve ligjore për votën e shqiptarëve jashtë vendit.

Pas diskutimeve të shumta në fund të mbledhjes që zgjati përreth tre orë, kreu i KQZ-së Celibashi u shpreh se çdo akt do të diskutohet me përfaqësues të Diasporës dhe brenda 2-3 ditëve do të ketë një narrativë mbi aktet.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale e ndryshme në Diasporë rrjetiprofesionisteve.al

Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet QSPA dhe Muzeut Historik Kombëtar


në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar, është firmosur marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe këtij institucioni të rëndësishëm të ruajtjes dhe promovimit së kujtesës historike së kombit tonë. Të pranishëm në aktivitet ishin Drejtoresha Ekzekutive e QSPA, Prof. Diana Kastrati, dhe Drejtoresha e Drejtorisë së Studimeve në QSPA Dr. Vilma Proko, si dhe Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar Dr. Dorian Koçi.

Të dyja palët u angazhuan për bashkëpunim reciprok në kryerjen e studimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta shkencore e kulturologjike, në realizimin e botimeve të përbashkëta, si dhe të konferencave shkencore, simpoziumeve apo tryezave të diskutimit, si dhe aktivitete të tjera promovuese që lidhen me komunitetin arbëresh, dhe kanë ndikim në ruajtjen e gjuhës, kulturës, traditave dhe trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale shqiptare.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

FSHZHD / Forum virtual me anëtarët e “Rrjetit të Profesionistëve të Diasporës”



“Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës” organizoi sot forumin virtual “Bashkëbisedim me anëtarët e rrjetit të rrjetit”. Ky forum ka si synim të krijojë një urë komunikimi me anëtarët e rrjetit të “Rrjetit të Profesionistëve të Diasporës”.

Në këtë event, pjesëmarrësit u njohën më shumë me rrjetin e profesionistëve të Diasporës, digjitalizimit të veprave shqiptare dhe mundësive që ofrojnë këto platforma.

Projekti “Diaspora për Zhvillim” ka si objektiv rritjen e kapaciteteve dhe rrjetëzimit të kapitalit shoqëror në Diasporë, si një vlerë e shtuar për zhvillimin ekonomik të vendit. Deri më tani 1831 profile janë bërë pjesë e Rrjetit të Profesionistëve të Diasporës, përfshirë këtu profesionistë në fusha të ndryshme, organizata dhe biznese.



Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

adld.al

GREQI/ Mësuesit në Athinë marrin librat e dërguar falas nga QBD



Shumë fëmijë shqiptarë që jetojnë në Greqi janë pajisur me libra në gjuhën shqipe, duke nxitur kështu edhe më tej dëshirën e tyre për gjuhën amtare.

Qendra e Botimeve për Diasporën vijon dorëzimin e librave për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporën shqiptare në Greqi, nën kujdesin Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe me mbështetjen e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Oficerja Koordinuese për Diasporën në Athinë, Joneda Dodaj, mirëpriti në ambientet e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi, mësuesen e gjuhës shqipe pranë “Rrjetit për të Drejtat e Fëmijëve” në Athinë, Ilira Ndrio Bakalli, të cilës iu dorëzuan librat shkollorë dhe jashtëshkollorë për vitin 2020-2021.

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



Diaspora Shqiptare

SHKARKO
APLIKACIONIN FALAS

App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)